



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-111/01-33766
Datë: 15.07.2024



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKESISË FAMILJARE**

Bazuar ne nenin 78,80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Dy (2) Laborant Mjekësor në QKMF-Lipjan

Detyrat dhe përgjegjësitë për Laborant:

1. Përgjigjet për marrjen e të gjitha analizave laboratorike hematologjike dhe biokimike sipas udhëzimit të mjekut.
2. Kryen analiza hematologjike biokimike si dhe të gjitha analizat tjera në QKMF,QMF dhe AMF në përputhje me standardet dhe rregullat në fuqi duke i kushtuar kujdes të vazhdueshme nevojave dhe kërkesave të klientëve dhe rritjes permanente të nivelit të besueshmërisë së rezultateve.
3. Është përgjegjës për regjistrimin e pacienteve në protokollat shëndetësore.
4. Bën përshkrimin e analizave hematologjike ,biokimike e të tjera në protokollat e pacienteve dhe formularin laboratorik.
5. Gjatë punës se ti/saj kujdeset për enët laboratorike dhe sterilizon ato.
6. Zbaton kodin e sjelljes profesionale dhe respekton etiken profesionale si dhe kujdeset për zbatimin e planit të punës duke respektuar orarin e punës sipas kontratës.
7. Përgjigjet për mbrojtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës, përgjigjet për bërjen e analizave me profesionalizëm, cilësi dhe saktësi përcjell dokumentimin e analizave të kryera.
8. Përgjigjet për mirëmbajtjeje e aparaturave dhe pajisjeve të tjera dhe pranimin e materialit për laborator.
9. Kryen edhe punë tjera laboratorike me kërkesën e shefit të laboratorit, Drejtorit të QKMF-së

Kushtet dhe kriteret:

- Fakulteti i Mjekësisë Bachelor -Drejtimi Laborant Mjekësor
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.

Paga mujore:

Grupi H klasa H17 **Koeficienti:5.4**
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar
Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 16.07/2024 deri me 14.0/2024 që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini


